

## BALADAT POPULLORE ME TEMATIKË TË FLIJIMIT

IZAIM MURTEZANI

Instituti i Folklorit 'Marko Cepenkov', Shkup, MAQEDONI  
izaim\_murtezani@yahoo.com

AKTET V, 4: 665-671, 2012

### PERMBLEDHJE

Baladat popullore me tematikën e murimit vazhdojnë të mbeten një perlë e rëndësishme e letërsisë sonë popullore. Meqenëse përmbajtja e tyre i kalon kufijtë kombëtar dhe është pjesë përbërëse edhe e krijimtarisë popullore të popujve të Ballkanit, por edhe më gjerë, ajo vazhdimisht ka cytur interesimin e studiuesve të ndryshëm, madje edhe të përmasave ndërkombëtare. Kjo ka ndikuar që të paraqiten edhe qasje të ndryshme teorike në interpretimin e tyre. Në këtë kontekst duhet veçuar interpretimin strukturalist – semiologjik, interpretimin feminist, interpretimin psikoanalitik e kështu me radhë. Disa nga këto këndvështrime kanë ndikuar që përmbajtja e këtyre baladave të venerohet jashta kontekstit të drejtpërdrejtë përmbajtësor, por në një kontekst më të gjerë duke përfshirë edhe atë metaforik, apo figurativ. Kjo ka ndikuar që përmbajtja e baladave në fjalë të përfitojë interpretime të ndryshme, por njëherit inspirative, pasi nëpërmjet tyre mëtohet të depërtohet në esencën e fenomenit të flijimit. Pra, në fokusin e punimit në fjalë janë disa nga këto qasje teorike të cilat përfaqësohen nga studiesit e mirënjohur, si Parpullova, Mendel, Dandis e kështu me radhë.

**Fjalë kyçe:** Mit, ritual, flijim, martesë, urë, baladë, nuse e re, ndërtim, rishtari .

### SUMMARY

Popular ballads with theme of the walled-up wife are an important part of our popular literature. Since their content crosses national borders and is also an integral part of popular creativity of the Balkan peoples, but and the further, it consistently has spurred interest of different researchers, even the international scale. This has contributed to the different approaches presented in the theoretical interpretation. In this context should be separated structural-semiological interpretation, feminist interpretation, psychoanalytic interpretation and so on. Some of these approaches have influenced the content of these ballads to observes the contents out of context, but in a broader context, including the metaphorical, or figurative. This has influenced the content of these ballads take different interpretations, but at the same time inspirative, because through them try to penetrate to the essence of the phenomenon of sacrifice. So the focus of this paper are some theoretical approaches which are represented by well-known authors as Parpullova, Mendel, Dandis and so on.

**Key words:** Myth, ritual, sacrifice, marriage, bridge, ballad, construction, initiation.

---

### 1. Midis pretendimeve nacionaliste dhe objektivitetit shkencor

Baladat me tematikën e murimit paraqesin krijimet më të njohura në folklorin shqiptar, por njëherit edhe në folklorin e popujve ballkanik, por edhe më gjerë. Këto balada, përkatësisht versionet e tyre duke u cilësuar si një ndër perlat më sinjifikative në kuadër të vlerave të

përbashkësive të kulturës shpirtërore të popujve të Ballkanit, kanë zgjuar vëmendjen e shumë studiuesve të ndryshëm. Fatkeqësisht, një numër i madh i studiuesve të tillë, veçmas ata me prejardhje joshqiptare duke mos e njohur gjuhën shqipe, nuk kanë pasur mundësi të shijojnë edhe vlerat ideo-estetike të baladave shqiptare me

tematikën në fjalë, andaj si rrjedhojë e kësaj, ato janë anashkaluar në studimet e tyre.

Në vija të përgjithshme, studimet teorike destinuar baladave të murimit janë përqëndruar në dy çështje themelore. Çështja e parë kishte të bënte me gjetjen e vendburimit të këtyre baladave, në të vërtetë me zbulimin e enigmës se cili kishte qenë ai popull që i kishte poseduar fillimisht baladat në fjalë e pastaj ato më vonë ishin huazuar nga të tjerët. Ndërkaq, çështja e dytë e baladave në fjalë, ishte e shkarkuar nga preokupimi i gjenezës së baladës dhe në epiqendër të saj, kishte shpjegimin e flijimit si bazë e përbajtjes së baladës, por të kundruar si një fenomen antropologjik në një kontekst të caktuar kohor dhe hapësinor.

Studiuesit e parë, por kushtimisht edhe më të hershëm, nën ndikimin e shkollës së migrimit që predikonte bartjen e temave dhe motiveve nga një vend në një tjetër, apo nga një popull në një tjetër, mbanin qëndrime të atilla që favorizonin versionet e baladave amtare të flijimit duke u përpjekur të përdëftojnë se ato kishin njohur praninë e parë në gjirin e popullit të tyre, kurse pastaj ishin shpërndarë te popujt tjerë fqinj ose më të largët. Pra, në frymën e monogjenezës, studiuesit e tillë, në funksion të misionit të afirmimit, apo më mirë thënë, idealizimit të vlerave të kulturës vetanake, pandehnin se ato ishin me natyrë burimore, gjenuine, të përkryera estetikisht e kështu me radhë.

Duke u ndërlidhur me këtë qasje të studimit të baladave me tematikën e flijimit, studiuesi i njohur botëror Alan Dandis në një punim të tij, konsideronte se për shkak të këtij etnoncentrizmi, folkloristët ballkanik kishin rënë në kurthin e nacionalizmit provincial. Kjo kishte ndikuar që ata në vlerësimet e tyre shkencore të ishin të njëanshëm duke viktimizuar me këtë rast objektivitetin shkencor. Dandis shton se këta autorë duke u udhëhequr nga emocionet e thella dhe paragjykyemet e tyre nacionaliste, i kishin bërë këto gabime: gabimi estetik që nunkuptonte shpalljen e versionit të baladës së përkatësisë etnike të studiuesit si më të bukurën. Argumentimet e ideve të këtilla ishin të nxitura nga epshet e mëdha nacionaliste. Gabimi tjetër,

sipas Dandisit, ishte gabimi interpretues. Në disa tentime për interpretimin e baladës në fjalë, nacionalizmi tejet i madh kishte luajtur rolin kyç.

Nga kjo që theksuam më lartë mund të konstatohet se energjia fillestare e studiuesve ishte derdhur në përcaktimin e vendburimit të baladave të flijimit dhe kishte prapavijë të afirmimit të kulturës kombëtare, kurse më vonë do të shohim se energjia e studiuesve do të orientohet kah interpretimi i aktit të flijimit, kryesisht si një fenomen antropologjik i një kohe dha hapësire të caktuar. Me këtë rast do t'i kushtohet rëndësi e veçantë edhe interpretimit metatekstual, apo metaforik të baladave në fjalë.

## **2. Interpretimi metatekstual, metaforik, apo i tërthortë i baladës së murimit**

Në kuadër të interpretimeve që përbajtjen e baladës në fjalë e shohin nga një dioptri tjetër, vlen të veçohet *interpretimi strukturalist – semiologjik*. Në kontekst të këtij interpretimi duhet përmendur studiuesen Ljubomira Parpulova e cila ofron një qasje tjetër që dallon nga qasja e studiuesve të mëparshëm. Ajo, veçmas është kritike ndaj Mihail Arnaudovit, pasi konsideron se ai, por edhe të tjerët, e lexojnë baladën fjalë për fjale, apo në mënyrë të drejtpërdrejtë. Kundruall tyre, Parpulova angazhohet për një “semantikë të thellë” dhe si rrjedhojë e kësaj, i qaset tekstit të baladës nga aspekti strukturalist – semiotik. Si pikë fillestare të leximit të baladës së murimit, ajo e merr qasjen e Vlladimir Propit i cili kërkonte invariantet morfologjike në përrallat ruse. Në baladën e murimit, përkatësisht versionet ballkanike të kësaj kënge, ky invariant morfologjik, sipas Parpullovës, është pikërisht motivi i flijimit të gruas – nënë – nuse.

Studiuesja e njëjtë duke cituar folkloristin hungarez Lajosh Vargas thekson se ai në hulumtimet kushtuar historisë mesjetare të baladës popullore, përmend një numër të madh të këngëve për murimin nga Gruzia dhe Moldavia, si dhe shumë legjenda me temën e njëjtë në Evropën Qendrore dhe Lindore. Në të gjitha këto krijime folklorike, në shumicën e rasteve, në themelet e ngrehinës murohet fëmijë.

Vlerësim i përgjithshëm është se ritualet e ndërlidhura me ndonjë ngrehinë arkitektonike, rregullisht kërkojnë ndonjë viktimë, por janë indeferent sa i përket llojit të subjektit që flijohet. Atëherë pse në të gjitha versionet e baladave ballkanike, invarianti morfologjik është pikërisht gruaja – viktimë, parashtron dilemën e saj Parpulova. Në disa versione greke, kjo edhe haptazi bëhet e ditur nëpërmjet fjalëve të zogut të vogël, përkatësisht kumtimit të tij se qenia e cila duhet të flijohet nuk duhet të jetë bonjak, i huaj, udhëtar i rastësishëm, apo njeri me të meta psikike e kështu me radhë. Këmbëngulësia për gruan-sakrificë në versionet ballkanike të baladës kundruall riteve dhe besimeve të praktikuara në jetë ku assesi nuk këmbëngulet në përkatësinë gjinore të viktimës që do të flijohet, si dhe prania e llojeve të tjera të sakrificës njerëzore në versionet joballkanike të baladës së njëjtë, për Parpulloven janë dëshmi e mjaftueshme dhe e sigurtë se syzheun e baladës nuk duhet ta derivojmë nga ritualet që kanë të bëjnë me ndërtimin e objekteve arkitektonike. Me fjalë të tjera, murimi nuk duhet të lexohet fjalë për fjalë, por vetëm si imazh, ose përfytyrim simbolik i cili është metaforik, ose figurativ. Së këndejmi, kuptim simbolik e jo të drejtpërdrejtë ka edhe ngrehina (qoftë urë, qytet, kështjellë, kishë) në baladat ballkanike.

Parpullova përmend shumë mënyra nëpërmjet të cilave do të mund të lexohet imazhi folklorik, apo simbolik i nuses-gruas-nënës së murosur, si dhe ngrehinës. Ngrehina që ndërtohet ditën, kurse natën rrëzohet është e ndërlidhur ngushtë me disa përfytyrime dhe ide mitike. Autorja, në bazë të folklorit bullgar, sjell shembuj të ndryshëm sipas të cilëve pjesë të ndryshme të kozmosit, apo ndërtimi i kozmosit, pason si rrjedhojë e viktimizimit të ndonjë subjekti - femër. Kështu sipas një kënge bullgare, nga sytë e qenies mitike, apo Zanës së mbytur krijohen liqenet, nga trupi i saj - drunjte, kurse nga flokët krijohet bari – tërfili. Në një këngë tjetër, në vendin ku mbytet motra e pafajshme nga vëllai i saj, krijohet një kishë – manastir. Pra, nga këto shembuj dhe të tjerë, Parpullova konstaton se edhe ura dhe murimi që dalin nga subjekti i baladës në fjalë

mund të konsiderohen si imazhe të kreativitetit, apo krijimit të botës nga trupi i femrës.

Nga ana tjetër, Parpullova përmend edhe shembuj të tjerë nga krijimtaria popullore, por që ndërlidhen me segmente të caktuara të përmbajtjes së baladës. Shembujt e këtillë rrëfejnë se protagonistet – vajza, para martesës mbyllen në ndonjë kullë të errët për një kohë të caktuar. Të gjithë këto sekuenca që kanë të bëjnë me izolimin e vajzave para martesës, ringjallin asociacionin e riteve të kalimit, të studiuara hollësisht nga Arnold Van Genepi. Ndoshta, një shembull i një versioni shqiptar edhe mund të përkojë me këtë logjikë. Nusja para murimit kërkon: *Ni amanet une do t'ju la. / N'krahin e gjathtë ni penxhere t'ma lini, / Në vorr mua kur të më shtini* (EPSH, 1999: 23). Pra, shembujt e izolimit ritual (murim, mbyllje në vende të errta), paraqesin fazën e parë të rishtarisë. Autorja Parpullova konsideron se nga pikëpamja strukturaliste, leximi më adekuat i baladës së murimit do të ishte ai që i ndërlidh këto imazhe folklorike me simbolikën e martesës dhe jetës martesore. Ky motiv, pra reflekton pashmangshmërinë e fatit të gruas, të transformohet në themelet e një ndërtimi të ri, bote të re, familje të re. Kjo sado që të jetë fisnike, jo çdoherë është e këndshme, konkludon autorja.

Një version tjetër i interpretimit të baladës së murimit rezulton nga shkolla *feministe, apo e studimeve gjinore*. Ky interpretim bazohet në pozitën dhe rolin që luan femra në një krijim folklorik. Në kontekst të hulumtimeve më të reja folklorike duhet të përmendet një studim i autores Sato Apo e cila nëpërmjet një perspektive antropologjike dhe sociohistorike, mëton të trajtojë problemin e raporteve gjinore. Në përputhje me horizontin e ri të pritjes, ajo zbulon se distinkcioni seksor/gjinor, në të dy llojet e përrallave, qofshin ato mashkullore, apo femërore, është kundruar nga perspektiva mashkullore. Pra, edhe meshkujt edhe femrat janë paraqitur në përputhje me kulturën dominante mashkullore (Apu, 1995).

Një interpretim joshës i kësaj natyre duke u ndërlidhur drejtpërsëdrejti me baladën e murimit

është ai i antropologes Ruth Mendel. Ajo duke i analizuar baladat greke, ofron interpretim interesant, nënkuptohet, të natyrës feministe. Autorja në fjalë, sipas përmbajtjes së baladës, zhvillon dhe interpreton një varg imazhesh simbolike, si: ura, murosja e gruas, fuqia shëruese e qumshtit të gjirit të saj, etj. Të gjitha këtyre përfytyrimeve, apo imazheve simbolike, ajo u jep rëndësi të veçantë duke kërkuar mbështetje në konceptin “liminalitet”. Këtë koncept, në kuadër të riteve të kalimit, e kishte përmendur Arnold Genepi, kurse më tej e kishte zhvilluar dhe zgjeruar studiuesi Viktor Turner. Përndryshe, liminaliteti është ajo periudhë kohore e sprovës së procesit të rishtarisë (iniciacionit) kur rishtari ndodhet në gjendje ambivalente ontologjike. Rishtari, apo neofiti ende nuk është liruar nga shtrëngesat e identitetit të tij paraprak, por ende nuk ka kaluar në gjendjen e re. Rishtari nuk ka as statusin e gjendjes paraprake, por as statusin e gjendjes së ardhshme. Ai është edhe me gjendjen e mëparshme, por edhe me atë të ardhmen, apo edhe njëra, edhe tjetra. Bëhet fjalë për një gjendje në kufi, ose për një ontos, qenie të paqartë.

Sipas Mendelit, pozicionin struktural që e ka pasur femra në shoqërinë arkaike greke, ose më mirë, roli që i është dhënë asaj nga sistemi kulturor patriarkal, përkon me konceptin e liminalitetit. Dikotomia bazike që i ka rregulluar marrëdhëniet shoqërore dhe përkatesinë shoqërore në shoqërinë tradicionale greke, - kundërvënja mes inkluzivitetit (përfshirjes, apo integritit) dhe ekskluzivitetit (përjashtimit) është shprehur nëpërmjet nocioneve *dikos* dhe *ksenos* (insajderë dhe autsajderë). Kundërvënja *dikos* / *ksenos* - e zbatuar në marrëdhëniet familjare në shoqërinë tradicionale greke, pozicionin e insajderëve ua kishte dhënë të afërmve sipas gjakut, kurse pozicionin e autsajderëve ua kishte dhënë të afërmëve sipas linjës martesore. Femra, pra ka pasur pozicion të dykuptimtë, apo liminal: ajo nuk ishte as insajder dhe as autsajder.

Në funksion të nxjerrjes në pah të disa fragmenteve të caktuara të baladës ku del në shesh liminaliteti i femrës, ajo ndalet sidomos në sekuencën e baladës greke ku zhvillohet dialogu

mes mjeshtrit - murarorit dhe fuqisë mbinatyrore (demonit) se cili nga të afërmit të flijohet. Muratori e hudh poshtë mundësinë e flijimit të prindërve, vëllezërve dhe fëmijëve të vet, pasi nuk mund t'i zëvendësoj ata me të tjerë. Ai vendos ta flijoj gruan, pasi ajo mund të zëvendësohet, madje, sipas baladës, do ta gjejë edhe më të mirë. Ajo, pra gruaja është në mënyrë të mjaftueshme në cilësinë e insajderit për t'u konsideruar si një e afërme e murarorit, por, në masë të madhe është edhe autsajder – andaj konsiderohet më pak e vlefshme se anëtarët tjerë të familjes. Pra, të parët janë të pazëvendësueshëm, kurse gruaja është e zëvendësueshme, inferiore dhe strukturalisht jo e barabartë me insajderët tjerë. Ndoshta në këtë drejtim edhe më transparente janë baladat shqiptare, në të cilat vërehet një zëvendësim i menjëhershëm i gruas së murosur. Madje, zëvendësimi bëhet me nismën e kësaj të fundit e cila në prag të murimit thotë: *Kayre nusja shka po ban: / - Ngoni knej, kunet, ju ka thanë, / shum selam nanës t'm'i bani! / Shtatëmdhetë vjeç ni motër e kam - / burrit tem qato m'ja dhanë / se pej bese kaka kanë taman* (BL, 1974: 12). Pra, baladat shqiptare dallohen me këtë veti nga baladat tjera ballkanike, si dhe me vetinë tjetër se të gjitha protagonistet – nuse nuk ngurojnë të flijohen kur e kuptojnë këtë. Ndërkaq, në variantet e popujve të tjerë ballkanik ndeshet, apo është i tejdukshëm kundërshtimi që bën gruaja për t'u flijuar, madje ajo në këto çaste lëshon edhe mallkime të ashpra ndaj atyre që e flijojnë. Dihet se në shumë artefakte mitologjike dhe letrare, ai që flijohet patjetër të pranoj në mënyrë vullnetare këtë mision me qëllim që të jetë i suksesshëm komunikimi i njeriut me qeniet mbinatyrore. Nusja e re shqiptare që flijohet në themelet e një ngrehine i ngjason lfigjenisë greke e cila syapatrembur shkon drejt altarit të flijimit. Ndoshta, edhe ky fakt, sidomos te balada shqiptare manifeston një element të lashtësisë krahasuar me baladat tjera ballkanike.

Autorja në fjalë, edhe disa sekuenca tjera të strukturës narrative të baladës së murimit, i veneron nga pozicioni i liminalitetit. Ura, si ngrehinë arkitektonike e baladës, paraqet lidhje

mes dy vendeve, apo brigjeve, por nuk i takon as njërit e as tjetrit breg. Ndodhet mes dy territoreve, duke i bashkuar, por njëkohësisht edhe duke i ndarë. Po ashtu edhe dialogu mes zogut dhe nuses së re që duhet të flijohet përmban elemente të ambivalencës, apo liminalitetit. Zogu ia dërgon nuses porosinë e gabuar, pasi në vend që t'i thoshte ta zvarriste shkuarjen e saj te ura, i thotë të shkonte sa më shpejt te ura.

Ambivalenca vërehet edhe në pyetjen që nusja ia parashtron zogut: vallë të shkonte e veshur me rroba të zeza, apo të vendoste stolitë e arit. Përgjigja e zogut është po ashtu ambivalente, pasi ajo nuk duhej të shkonte as për të mirë e as për të keq, por ashtu siç ishte. Bëhet fjalë për një gjendje që është jashta rregullit, apo rendit të zakonshëm shoqëror, gjendje që është “diçka në mes”, as mirë dhe as keq. Në një version të baladës shqiptare paraqitet qyqja si ndërmjetëse mes kësaj dhe botës tjetër. Në të vërtetë nusja e re gjatë rrugës për te ura ka parandjenjën e murimit, andaj komunikon me qyqen: - *Këndo, çyçe, mos pusho! / Këndo e për mu vajto* (BL, 1974: 16). Të theksojmë se shpendët në mitologjinë ballkanike, por edhe më gjerë, paraqesin ndërlidhje mes kësaj bote dhe botës tjetër (shqiponja, korbi, qyqja etj.).

Lista e sekuencave me pozicion të liminalitetit mund të jetë shumë e gjerë. Në këtë drejtim edhe subjekti që vëllezërve-mjeshtër ua kumton lajmin e murosjes së viktimës, në shumicën e rasteve, edhe në baladat shqiptare, është me attribute mbinatyrore, apo të shenjta. P. sh. – *Puna e marë, o ustallarë! / - Të marë paç, o shenjt i gjallë!* (BL, 1974: 3). Protagonistët e tillë mund të interpretohen si ndërmjetës tipik mes kësaj bote dhe botës tjetër. Në funksion të liminalitetit mund të jetë edhe ëndrra që i fanitet subjektit – nuse. P. sh. *(Ni) anërr e shtirë m'u ka diftue - / diqyshn'anërr m'kanë pre mue* (BL, 1974: 8). Dihet se sipas besimit popullor, ëndrrat kumtojnë porosi të caktuara dhe ndërlidhja e tyre është evidente midis kësaj dhe botës tjetër. Po ashtu, gjithnjë sipas baladave shqiptare, me attribute të liminalitetit, mund të perceptohet edhe dera e oborrit. P. sh. *E muer bukën, po fillon. / N'derë*

*t'oboorit kur po shkon / edhe ni herë kthye m'ish kanë, / po ma thirr: - Oj e emja nanë* (BL, 1974: 11). Dera e oborit paraqitet si kufi mes së jashtmes dhe së brendshmes, mes së nohurës dhe panjohurës, mes times dhe huajës e kështu me radhë.

Me pozicion ambivalent është edhe gjiri i djathtë i nuses së murosur i cili komunikon mes kësaj dhe asaj bote. Sipas baladave shqiptare, qumshti i gjirit të saj, edhe pas vdekjes, shuan etjen e foshnjës së saj, por njëkohësisht ky qumsht shëron edhe verbësinë. Edhe figura e gjelit që paraqitet në disa versione shqiptare është me attribute liminale. *Zu sabahi me u ague / edhe knojsit zunë me knue. / Nimo zo' vllaznit janë çue* (BL, 1974: 14). Dihet se gjeli, sipas mitologjië, paraqet simbol të ndërrimit të dy periudhave të kundërta kohore - ditës dhe natës, andaj konsiderohet si qenie me attribute lunare dhe solare. Edhe numri tre, aq i dendur në përmbajtjet e baladave paraqitet me funksione liminale, në të vërtetë si simbol i kësaj bote dhe botës tjetër në dy sfera, si bota qiellore dhe ajo nëntokësore.

Baladës në fjalë, apo me tematikën e murimit, i qaset edhe studiuesi i mirënjohur Alan Dandis. Ai konsideron se ekzistojnë shumë lexime të mundshme të baladës. Vetë Dandis ofron dy: një nga aspekti i nuses së murosur e cila është e inspiruar nga interpretimi feminist, kurse tjetra nga aspekti i mjeshtër - muratorit, apo interpretimi *psikoanalitik* i baladës. Nëse e lexojmë baladën nga aspekti i gruas – sakrificë, atëherë mesazhi i këtij krijimi folklorik është se martesë paraqet kurth për gruan. Balada e flijimit të nuses është metaforë e jetës martesore në të gjitha shoqëritë në të cilat këndohet. Me aderimin në jetën martesore, gruaja figurativisht murosset. Fakti se burri është i gatshëm ta flijoj gruan e vet me qëllim që të ndërtoj kështjella më të mëdha dhe më të mira, ura, kisha e kështu me radhë, e vë në dukje statusin inferior të grave në këto shoqëri.

Dandis në vënderimin e përmbajtjes së baladës nga perspektiva e mjeshtër – ndërtues, i jep asaj një lexim krejtësisht tjetër, apo më mirë thënë, e veneron atë nga *aspekti psikoanalitik*. Pa marr

parasysh se për çfarë ndërtimi bëhet fjalë, në të gjitha versionet, ajo gjatë ditës ndërtohet, kurse gjatë natës rrëzohet. Pra, bëhet fjalë për fantazi e jo për diçka që realisht është e mundshme, andaj këtë motiv Dandisi e interpreton si metaforë të ereksionit mashkullor. Burrat frikësohen se nuk do të mund ta ruajnë ereksionin e tyre, veçmas në mbrëmje kur është koha e zhvillimit të marrëdhënieve seksuale. Burrat kanë nevojë ta manifestojnë maskulinitetin e tyre nëpërmjet mohimit të çdo lloj varësie nga gratë. Psikoanalisti Bruno Betellhajm, vë në dukje detyrën e dëndur që u jepet rishtarëve gjatë riteve adoloshente të kalimit – të imitojnë më saktësisht sjelljen prokreative të gruas. Ndërtimi i ndonjë ngrehine (ngritja e saj, ereksioni) me ç’rast në themelet e saj muroset gruaja, mund të lexohet si fantazi mashkullore për ereksion të vazhdueshëm. Por tentimi që falusit t’i jepen atributet e mitrës, përfundon në mënyrë tragjike me vdekjen e qenies njerëzore të murosur në “mitrën” e falusit. Pra, insistimi i mashkullit në ngritjen e ngrehinës së tij do të thotë se gruaja e tij e nënshtruar dhe e dëgjueshme, patjetër ta flijoj jetën e saj për këtë capric mashkullor (Dundes, 1995: 50).

### 3. Përfundim

Nga e gjithë kjo që theksuam më lartë rezulton se folkloristët duhet patjetër të pajtohen me shumësinë e interpretimeve që kanë të bëjnë me një tekst të njëjtë. Përderisa nuk ekziston një tekst korrekt, përkatësisht unik i një krijimi folklorik, aty nuk mund të ekzistojë dhe një “interpretim” korrekt i tij. Folkloristët patjetër duhet të mësojnë vetveten të pranojnë një shumësi interpretimeve, ashtu siç kanë mësuar të pranojnë ekzistimin e një shumësie të versioneve të teksteve (Dundes, 1995: 49-50). Megjithatë është i drejtë edhe pohimi i teorisë së recepcionit, sipas së cilës, çdo periudhë historike formëson horizontin e vet të pritjes, i cili nuk është statik, përkatësisht nuk është dhënë njëherë e përgjithmonë. Ndoshta edhe më i qartë në këtë drejtim është folkloristi Ben Amos, i cili në një vend thekson se interpretimi i shëndoshë është ai që përket tekstit në kuadër të kontekstit

të dhënë (Amos, 1993: 210-211). Konteksti i përfshin këto kategori: botëkuptimin, kulturën, sistemin, bazën kulturore dhe diskursin, horizontin ideologjik e kështu me radhë. Si rrjedhojë e kësaj, gjatë këtyre dekadave të fundit nuk kemi pse të flasim për nuse të murosur e cila është prodhim ose reminishencë e ritit të dikurshëm të murimit të viktimës njerëzore në themelet e një ngrehine për shkak të zbutjes së shpirtit të lig, por mund ta interpretojmë dhe ta perceptojmë edhe si rrëfim për gruan – nuse e cila me aktin e kurorëzimit e flijon jetën dhe lirinë e vet në dobi të bashkëshortit. Pra, “asociacionet e lexuesve nuk mund të jenë çdoherë të njëjta, pasi vetëdija e lexuesve nuk është diçka absolute, ajo nuk paraqet konstantë të pandryshueshme, përkundrazi – ajo vazhdimisht ndryshohet, varësisht nga kushtet historike dhe shoqërore”, thekson një ndër promovuesit e teorisë së recepcionit, Robert Jaus.

### BIBLIOGRAFIA

- APHAУДОВ, Михаил (1971): *Студии върху българските обреди и легенди*. Том 2. София.
- APU, Sato (1995): *The Narrative World of Finnish Fairy Tales. Structure, Agency and Evolution in Southwest Finnish Folktales*. FFC. No. 256. Helsinki. Academia Scientiarum Fennica.
- BL (1974): *Balada dhe legjenda*. Pregatitur nga Anton Çetta. Instituti Albanologjik i Prishtinës. Prishtinë.
- DANDES, Alan (1995): *How Indic Parallels to the Ballad of the “Walled-Up Wife” Reveal the Pitfalls of Parochial Nationalistic Folkloristics*. *Journal of American Folklore*. No. 427, pp.38-53.
- DANDES, Alan (1996): *The Ballad of “The Walled-Up Wife”*. *The Walled-Up Wife. A Casebook*. Edited by Alan Dandes. The University of Wisconsin Press.
- EPSH (1999): *Epikë popullore shqiptare*. (Mbledhur në Tetovë, Gostivar me rrethinë). Mbledhur dhe përgatur nga Hafezat Osmani. Shkup.
- JAUS, Robert (1978): *Estetika recepcije*. “Nolit”. Beograd.
- MANDEL, Ruth (1996): *Sacrifice at the Bridge of Arta: Sex Roles and the Manipulation of Power*.

*The Walled-Up Wife. A Casebook.* Edited by Alan Dantes. The University of Wisconsin Press.  
ПАРПУЛОВА, Любомира (1983): Баладата „Вградена невеста“. (Кратки бележки относно

структурата и семантиката. *Български фолклор*. Година IX. 1983. БАН. София..